



## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 03/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 616-19-3238-2-1-1

Sa i përket tenderit për: Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

K.S. Besa Security Sh.p.k.

Rr. Jusuf Gërvalla nr.64

Prishtine, 10 000

049/ 481 – 577

Jetmir Uka

[info@besasecurity.com](mailto:info@besasecurity.com), [jetmir.uka@besasecurity.com](mailto:jetmir.uka@besasecurity.com)

07.02.2020



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Parashtrimi i ankeses nga vet Kompanitë.

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 20.05.2019  
Data e publikimit të dosjes së tenderit: 17.05.2019  
Data e njoftimit për tenderuesin e eliminuar: 20.01.2020  
Data e paraqitjes së kërkesës për Rishqyrtim: 27.01.2020  
Data e pranimit të vendimit për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim: 28.01.2020  
Kriteri i dhënies së kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

☒

Jo

☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Me 27.01.2020 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim të vendimit, me c'rast kemi kërkuar nga AK që të e Rishqyrtoj vendimin e marrë me 20.01.2020, duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e cekura dhe në dispozitat e LPP-se.

AK ka marrë vendim me të cilin ka Refuzuar kërkesën tone për ri-shqyrtim dhe ka bërë Vertetimin e njoftimit të publikuar me 20.01.2020, me c'rast ka vendosur të vazhdoj respektimin e Vendimit të datës 20.01.2020!



## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunes së Prishtinës, ka bërë shkeljen e:**

**Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve i Ligjit Nr. 04/L-042,  
Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës i Ligjit Nr. 04/L-042,  
Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi i Ligjit Nr. 04/L-042.**

*\*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përkrahësi rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Të nderuar,**

Perkunder që ne Dosje të Tenderit, AK nuk e ka çekur që paga prej 250.00€ është Page Baze dhe nuk përfshin orët e Nates, me c'rast është nenkuptuar që paga e Punëtorit bazuar në punën e zakonshme Rotative është 250.00€. Paga bruto mujore nenkupton pagën në fund të muajit që i paguhet punëtorit.

Perkunder që ne, në sqarimet e dërguara tek AK kemi thënë se zëvendësimet i bëjmë me punëtor të tjerë të cilët kanë paga më të ulta, sic edhe e lejon ligji i punës dhe vendimi i qeverisë me page prej 130.00€. Ne kemi bërë kalkulimin me orë totale duke shfrytëzuar tabelën baze që AK ka paraqitur në Dosje të Tenderit përkatësisht në Përshkrimin e Cmimeve, me c'rast janë bërë kalkulimet në excel, formë në bazë të mënyrës së si jemi ardhur deri tek cmimi përfundimtar dhe perseri rezultojmë që jemi brenda buxhetit dhe cmimi është cmim normal i tregut.

Në anën tjetër punëtorët tona kanë ditë pushimi javor, por jo detyrimisht ato ditë duhet të jenë (E shtunë – E Diele) apo "VIKEND", që kupton se skemi nevojë të paguajmë shtesë/ekstra për punë vikendi kur ata e shfrytëzojnë pushimin javor gjatë ditëve tjera të javës!

Andaj në rastin konkret llogariten vetëm festat si pages shtesë/ekstra dhe sipas kalendarit zyrtar të festave janë 12 ditë gjatë një viti, gjegjësisht 1 ditë në muaj.

PËRSHKRIMI I CMIMEVE													
Pjesa nr.	Përshkrimi i pozitës (a)	Numri i pozitave (b)	Numri i orëve (c)	ROJE TE NEVOJSHME PER I POZITE	Numri total i orëve për ditë (d) = (b) x (c)	Numri total i orëve për 30 ditë (e) = (d) x 30	NR I ROJEVE NE BAZE TE ORARIT DITORE DHE NUMRIT TE POZITAVE	PAGA	Paga për 1 muaj	Paga shise +30% për h nate	12 festa/viti i dte/muaj	Pushimi Vjetor 4 jave	Total pa TVSH
1	Sigurimi fizik	35	24 orë	4	840	25200	140	250	35000	2625	437.50	2722.22	40784.72
2	Sigurimi fizik	1	16 orë	3	16	480	3	250	750	0	8.33	58.33	816.67
3	Sigurimi fizik	18	12 orë	2	216	6480	36	250	9000	0	75.00	700.00	9775.00
4	Sigurimi fizik	28	8 orë (nga 08:00-16:00)	1	224	6720	28	250	7000	0	116.67	544.44	7661.11
Cmimi total €													2125350.00
													382563.00
													2507913.00
													1732535.00
													34692.00
													415242.00
													325444.00



Duke pasur parasysh gjendjen faktike dhe reale te lartecekur ne deklarojme se: AK- Kuvendi i Komunes se Prishtines ka bere shkeljen e Nenit 59, Nenit 60 dhe Nenit 7 te Ligjit nr. 04/L-042, pasi qe:

a) AK – Kuvendi i Komunes se Prishtines ka eliminuar Kompanin tone nga ky aktivitet edhe pse ne kemi qene ne perpuethshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosje te tenderit, gjithashtu kompania jone ka dhene pergjigje sqaruese pran AK-se lidhur me cmimin e ofertuar, cmim i cili permbush te gjitha kerkesat e AK-se lidhur me pagesen e puntoreve.

b) Kompania jone ka permbushur te gjitha Kriteret per Dhenien e Kontrates duke qene edhe tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet te ofertuar.

c) Kompania jone ndjehet e Diskriminuar nga Vendimi i AK-se pasi qe perkunder se kemi permbushur te gjitha kerkesat e paraqitura ne njoftimin e kontrates dhe ne dosje te tenderit, AK ka parapare qe kontraten te i'a jap nje Grupi te Operatoreve Ekonomik te cilet jane me cmim me te larte per 167,961.60€!

d) Cdo Operator Ekonomik qe ka ofertuar cmimin mbi 2,507,913.00€ duhet konsiderohet si kompani / OE i pergjegjshem, per me shume detaje mund te i referoheni dokumentit te bashkangjitur ne kete Ankese si me lartë "fq 4/5" (Pershkrimet te cmimeve sipas formatit standard te AK-se).

Si perfundim rikujtojme se:

AK – Kuvendi i Komunes se Prishtines nuk ka respektuar ne perpikmeri Vendimin e OSHP-se nr. 735-744-757-19 të datës 09.12.2019, pasi që OSHP ka kerkuar nga AK permes vendimit ne fjal qe ti permbahet ne detaje te gjitha dispozitave te LPP-se, kerkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate, gjithashtu OSHP ka vertetuar (ka ardhur ne perfundim) se: ekzaminimi vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte bere konform nenit 59 te LPP-se dhe njekohesisht nuk eshte respektuar edhe neni 60 i LPP-se kriteri kryesor per dhenie te kontrates e qe ka qene tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet, shkelje kjo e perseritur edhe gjate rivleresimit te ofertave!

AK – Kuvendi i Komunes se Prishtines ka vepruar me standarde te dyfishta pasi qe:

Perfshire edhe kontraten e dates 19.08.2019 (me procedure te negociuar) lidhur me ofrimin e sherbimeve te sigurimit me cmimin prej 1.63€ per 1 ore pune, ka vendosur qe kontrata te i ipet per zbatim OE qe kane ofertuar me cmimin me te ulet, ndersa ne kete aktivitet te cilit po i referohemi AK – Kuvendi i Komunes se Prishtines cmimin prej 1.83€ per 1 ore pune e quan cmim jonormalisht te ulet!

Si përfundim, asnje Operator Ekonomik i pergjegjshem ne kete Aktivitet te Prokurimit, me cmimin e ofertuar nuk mund te beje permbushjen e Kerkesave Ligjore qe rrjedhin nga Ligji i Punes dhe Udhezimet Administrative ne 100%! Andaj duhet merret parasysh ky fakt dhe te shperblehet me kontrate Operatori Ekonomik i Pergjegjshem me cmimin me te ulet te ofertuar, pasi qe tani per tani bazuar ne vleren e parashikuar te projektit dhe cmimet e ofertuara kerkesat ligjore mund te respektohen vetem Pjeserisht!

.....

Veprimi i tille i Autoritetit Kontraktues "Kuvendit te Komunes se Prishtines", nuk respekton dispozitat e Ligjit per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, akteve tjera dhe Rregullores/Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik, andaj permes kesaj Ankese kerkojme qe

te kthehet tenderi ne Rivleresim, me çrast do te shpallet fituese kompania jone, si tenderi i pergjegjshem me cmimin me të ulët.

#### 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Shkeljet e supozuara kercenojne te na shkaktojne humbjen e mundesise ne fitim te kontrates dhe humbjen e fitimit te pritur te kompanis sone, kostot rreth 500.00€ per pergaditjen e tenderit, analizat dhe kohen e humbur per permbushjen e kerkesave te tenderit, pergaditjes se ankesave, bllokimin e mjeteve per Ankesë pran OSHP-se, etj.

Gjithashtu kerkojme nga OSHP, qe te obligohet AK "Kuvendi i Komunes se Prishtines" qe te beje kompenzimin e demit material ndaj Kompanis sone sipas Nenit 33 dhe 34 te Rregullores se Punes se OSHP-se.

#### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshmitë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- h) Përshkrimi i cmimeve sipas formatit te AK-se ku shihet kjarte se cdo cmim mbi 2,507,913.00€ eshte cmim i arsyeshem dhe nuk konsiderohet si jo-normalisht apo abnormalisht i ulët!
- i) Analiza Financiare (Pergjigjja Sqaruese Paraprake) per Autoritetin Kontraktues.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.